

## BASHKËPUNIMI SHQIPËRI- BULLGARI

Ministrja Belinda Balluku, priti në një takim homologun bullgar, Rosen Zheliazkov ku diskutuan një sërë çështjesh sa i takon zhvillimit të transportit. Të dy ministrat diskutuan mbi mundësinë e vendosjes së një linje ajrore Tiranë - Sofje dhe ranë dakord për një rifreskim të marrëveshjes së transportit detar mes dy vendeve. Transporti hekurudhor, ku asistencja e Bullgarisë si një vend me eksperiencë në këtë drejtim, është e mirëpritur, ishte një tjetër temë e diskutimit mes dy homologëve.

## REHABILITOHET NËNSTACIONI LAÇ 2

Përmes një investimi të OST u bë e mundur rehabilitimi i nënstacionit elektrik Laç 2, në të cilin për dekada me radhë nuk ishte bërë asnjë investim. Gjithashtu u realizua rikonstruksioni i linjës së tensionit të lartë 110 kV Laç 1- Laç 2. Falë kësaj ndërhyrjeje rritet cilësia e shërbimit ndaj abonentëve duke rritur sigurinë, ndërsa sigurohet edhe një tërheqje më e mirë e energjisë së prodhuar nga HEC-et.

## RIKONSTRUKSION GODINËS SË DRSHTRR LAÇ

Ka nisur puna për ndërtimin e godinës së DRSHTRR Laç, një investim i cili do të mundësojë kushte më të mira pune për punonjësit e kësaj drejtorie, si dhe ofrimin e shërbimit në kushte më dinjitoze për afro 97 mijë qytetarë në vit. Investimi përfshin rehabilitimin e të gjithë territorit, krijimin e një hapësire të re për arkivën si dhe rrjete të reja elektrike, informatike dhe inxhinierike.

## SIGURIA RRUGORE

Kanë përfunduar punimet rehabilituese në pesë kthesat në zonën e Qafë Thanës duke lehtësuar qarkullimin e automjeteve. Përmes kësaj ndërhyrjeje u bë e mundur riasfaltimi, vendosja e sinjalistikës horizontale dhe vertikale si dhe ndërtimi i bordurave të reja. Ndërhyrja u realizua përmes projektit të "Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate" me financim të Bankës Botërore me qëllim rritjen e sigurisë.

## BASHKËPUNIM NDËR- INSTITUCIONAL

DPSHTRR dhe Posta Shqiptare kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi mes tyre. Posta Shqiptare merr përsipër kryerjen e plotë të Shërbimit Postar Ekspres sipas nevojave të DPSHTRR dhe qytetarëve. Dërgesat ekspres do të dorëzohen për një afat kohor 24 orë në drejtoritë rajonale të largëta pa dëmtime, me ambalazh dhe sipas kushteve të sigurisë maksimale.

## OSHEE, RIPAROHEN DËMET NGA MOTI I KEQ

Moti i keq me reshje të dendura shiu dhe erëra të fuqishme shkaktoi dëmtime në disa zona të vendit në rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike. Gjatë gjithë javës grupet e punës së OSHEE kanë qenë në terren për të riparuar dëmet. Falë ndërhyrjes në kohë u bë e mundur riparimi i dëmeve në të gjitha zonat e prekura.